



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 172/2 Prot.

Tiranë, më 22 / 04/ 2013

Drejtuar: znj. LEFTERIJE LUZI (Lleshi)
KRYETARE
KOMISIONI QËNDROR I ZGJEDHJEVE

Lënda: Lidhur me masat e marra në kuadër të procesit zgjedhor për zgjedhjet e përgjithshme të datës 23 qershor 2013, për të garantuar të drejtën e votës për personat me aftësi të kufizuar.

TIRANË

E nderuar znj. Kryetare,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke ju referuar shkresës Tuaj me dt.11.03.2013 Nr. 2488/1 Prot., i vlerëson si shumë të rëndësishme masat e marra nga KQZ në kuadër të garantimit të së drejtës së votës për personat me aftësi të kufizuar. Këto masa do të çojnë në një shkallë më të lartë garantimin e kësaj të drejte themelore në procesin zgjedhor për zgjedhjet e përgjithshme të datës 23 qershor. Respektimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, fillon nga e drejta e votës dhe shtrihet në të gjitha fushat e jetës shoqërore.

Për sa i përket masave të marra nga KQZ, institucioni ynë kërkon një vëmendje të veçantë në këto dy pika:

Së pari, masat e marra nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e detyrimit për vendosjen e qendrave të votimit në katet e para të objekteve nga ana e qeverisjes vendore. Theksojmë se është e domosdoshme të gjendet një mjet i përshtatshëm për marrjen e informacionit nga organet e qeverisjes vendore, pavarësisht faktit që ky informacion nuk kërkohet në formularin Tip të miratuar nga KQZ.



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

Së dyti, për sa i përket masave të marra nga KQZ për garantimin e të drejtës së votës për personat me aftësi të kufizuara që nuk mund të dalin nga shtëpia, jemi të vetëdijshëm se Kodi Zgjedhor nuk e parashikon votimin për këtë kategori, por kjo e drejtë nuk mund të kufizohet vetëm brenda parashikimeve të Kodit Zgjedhor për atë kohë sa kjo e drejtë garantohet edhe nga akte si: **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë** në nenin 45 parashikon: “Çdo shtetasi që ka mbush moshën 18 vjeç, qoftë dhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtë të zgjedhë e të zgjidhet”; **Konventa Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar**, parashikon në Neni 29 “Pjesëmarrja në jetën politike dhe publike “Shtetet Palë duhet tu garantojnë personave me aftësi të kufizuar të drejtat politike dhe mundësinë për t’i gëzuar ato njësoj si pjesa tjetër e popullsisë dhe duhet të marrin përsipër a-Tu garantojnë personave me aftësi të kufizuar pjesëmarrjen e plotë dhe efektive në jetën politike dhe publike njësoj si gjithë të tjerët, drejtpërsëdrejti apo nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, duke përfshirë edhe të drejtën dhe mundësinë e personave me aftësitë kufizuar për të votuar dhe për tu zgjedhur, ndër të tjera duke(.....)”; **Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “ Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”** në nenin 9 parashikon: “Ndalohet diskriminimi në ushtrimin e së drejtës për të zgjedhur, për t’u zgjedhur dhe për t’u emeruar në një detyrë publike, për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji” etj.

Komisioneri për Mbrojtjen nga diskriminimi, thekson nevojën e gjetjes së zgjidhjeve të përshtatshme për garantimin e të drejtës së votës për personat me aftësi të kufizuar që nuk mund të dalin nga shtëpia e kjo kategori të shihet me prioritet pasi mund të mos kenë patur as një herë mundësinë për të ushtruar të drejtën e votës, si një e drejtë kushtetuese.

Gjithashtu, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në përputhje me kompetencën e tij të parashikuar në nenin 32 pika dh) të Ligjit 10 221 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, kërkon të caktojë vëzhgues të saj për vëzhgimin e përgatitjes dhe zhvillimit të zgjedhjeve dhe të gjitha fazat e procesit zgjedhor, me fokus monitorimin e ushtrimit të së drejtës së votës për personat me aftësi të kufizuar, në zgjedhjet e përgjithshme të datës 23 qershorit 2013. Institucioni ynë është i gatshëm të zbatojë të gjitha detyrimet që lindin për vëzhguesit e akredituar, të përcaktuara në Kodin Zgjedhor e akte të tjera nënligjore.

Duke besuar në bashkepunimin dhe mirëkuptimin Tuaj,

Konc: Klodiana Kamberaj

Kaliro Martiko



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al